



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:097187

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05741795

K.Dh.Sh.II.nr 954/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija-Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Telekomi i Kosovës Sh.a, me nr.unik identifikues 81128801 me seli në Prishtinë, lagjia Dardania, të cilin e përfaqëson B.H., kundër paditurit Dardafon Net L.L.C me nr.të biznesit 810745416 dhe seli në Fushë Kosovës, Miradi e Epërme, rr. “Dëshmori”, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Faton Qerezi avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë–Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.151/2024, të datës 27.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit Telekomi i Kosovës Sh.a dhe Aktevendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë–Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.151/2024, të datës 27.03.2024 Vërtetohet .

A r s y e t i m

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë–Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.151/2024, të datës 27.03.2024, ka vendos si në vijim;

I.Gjykata Komeriale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike SHPALLET JO KOMPETENTE në pikëpamje absolute për të vendosur sipas padisë së paditësit Telekom i Kosovës Sh.a, kundër të paditurit Dardafon.Net L.L.C, me objekt kontesti anulim i vendimit të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë nr.24841/MHM/HHB të datës 18.02.2022.

II.SHPALLEN TË PAVLEFSHME të gjitha veprimet procedurale të kryera nga gjykata në këtë çështje kontestimore.

III.HEDHET POSHTË si e palejuar padi e paditësit Telekom i Kosovës Sh.a, kundër të paditurit Dardafon.Net L.L.C, me objekt kontesti anulim i vendimit të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë nr.24841//MHM/HHB të datës 18.02.2022 në mungesë të kompetencës së gjykatës vendore në trajtimin e çështjes.

Kundër këtij aktvendimit në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, për shkak të zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktvendimin e ankimuar ta prish, dhe çështje ta kthej në rigjykim dhe rivendosje Dhomës së Shkallës së Parë.

Përgjigje në ankesë, ka paraqit e paditura me të cilën ka kërkuar që të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Gjykata Komeriale-Dhoma e shkallës së dytë, i ka shqyrtuar dhe vlerësuar, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, shkresat e lëndës secilën veç e veç dhe lidhëshmërin e tyre, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi Telekom i Kosovës Sh.a me nr.NRB810218794, me seli në Prishtinë, ka parashtruar në gjykatë kërkesë për anulimin e Vendimit të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) ne.24841/MHM/HHB të datës 18.02.2022.

Gjykata Komerciale e Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të padisë dhe vlerësimit të shkresave të lëndës ka ardhë në përfundim se e njëjta nuk ka kompetencë absolute për të vendosur lidhur me padinë e paditësit, si dhe padinë e paditësit Telekomi i Kosovës sh.a me seli në Prishtinë e ka hudhë si të palejuar në mungesë së kompetencës së gjykatës vendore, ndërsa vendimin e saj e ka mbështet në dispozitat e neneve 36,38 par 2 dhe 39 par 4 pika (e) të Ligjit për Arbitrazhin (LA), si dhe në nenin 1 dhe 5 par. 1 pika (e) të Konventës së Nju Jork-ut, lidhur me nenin 26 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Procedurës Kontestimore, e po ashtu duke u bazuar edhe në Udhëzuesin e Komisionit për të drejtën Ndërkombëtare Tregtare të Kombeve të Bashkuara (UNCITRAL), ka shtuar se nga Konventa për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit dhe Ligjit mbi Arbitrazhin i Kosovës qartazi përcaktohet që kompetenca e vetme e gjykatës vendore të së cilës kërkohet njohja dhe ekzekutimi i një vendimi të huaj të arbitrazhit është mundësia e refuzimit të njohjes së tij, dhe atë vetëm në rast të plotësimit të një prej shkaqeve të përcaktuara me nenin 5 të Konventës ndërlidhur me nenin 39 par.4 të LA-së, e të cilat rrethana janë ekuivalente me shkaqet për anulimin e vendimit të arbitrazhit vendor, por në asnjë rrethana nuk i njihet kompetencë gjykatës vendore që ta anuloj vendimin e huaj të arbitrazhit.

Dhoma e Shkallës së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë e mbështet në tërësi konstatimet dhe shpjegimet lidhur me faktet dhe rrethanat vendimtare të cilat kanë prurë që të miret një aktvendimi për shpalljen e jokompetencës, e që në mënyrë të thukët i ka dhënë Dhoma e Shkallës së Parë. Dhoma e Shkallës së Dytë po ashtu konstaton se nuk qendrojnë pretendimet ankimore sa i përketë vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sepse gjykata ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe ka gjetë se çështja faktike është vërtetuar drejtë dhe në bazë të kësaj

çështje faktike drejtë janë aplikuar dispozitat ligjore, të cekura më hollësisht në aktvendimin e kundërshtuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë gjithashtu vlerëson se nuk qendrojnë pretendimet ankimore, lidhur me shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, sepse Gjykata e Dhomës së Shkallës së Parë me zbatimin e drejtë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe me zbatim të drejtë të së drejtës materiale ka marrë aktvendim me të cilën është shpallë jokomptente për të vendosur sipas padisë së paditësit Telekom i Kosovës sh.a kundër Dardafon.Net L.L.C për anulimin e vendimit të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë nr.24841/MHM/HBH/ të datës 18.02.2022, dhe kjo gjykatë e mbështet vlerësimet e Gjykatës së Dhomës së Shkallës së Parë se, kompetencën e gjykatës vendore në Republikën e Kosovës përcaktohet me Konventën për Njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të Arbitrazhit e vitit 1958 (Konventa e Nju Jork-ut) e cila gjen zbatim në pajtim me nenin 26 të Ligjit nr.04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK). Ku me nenin 1 të Konventës së Nju Jork-ut është paraparë që *“Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, që janë në territorin e një shteti të ndryshëm prej atij ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi i vendimeve, dhe që u përkasin marrëveshjeve midis personave fizikë dhe juridik”*, si dhe me nenin 39 par.1 të LA-së, është paraparë se *“Gjykata e Kosovës i njohin vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës sit ë plotëfuqishëm dhe i ekzekutojnë ato nëse vendimet në fjalë janë njohur dhe janë shpallur të ekzekutueshëm sipas paragrafëve 2 deri 5 të këtij neni”*, e po ashtu edhe me nenin 5 par.1 pika (e) të Konventës së Nju Jork-ut, dispozitë kjo në përputhje me nenin 39 par 4 pika (e) të LA-së, parasheh se njohja dhe ekzekutimi i vendimit të huaj të arbitrazhit mund të refuzohet me kërkesën e palës kundër së cilës drejtohet, vetëm në qoftëse ajo palë i paraqet autoritetit kompetent ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi provën që *“vendimi nuk ka marrë formën përfundimtare për palët, ose është anuluar soe pezulluar nga organi kompetent i vendit në të cilin, ose sipas ligjit të të cilit është dhënë vendimi”*, ndërsa nga Udhëzuesi i Komisionit për Drejtën Ndërkombëtare Tregtare të Kombeve të Bashkuara (UNCITRAL) për zbatimin e Konventës së Nju Jork-ut, qartësohet se me termin *“organ kompetent vendit të cilin është dhënë vendimi”* nënkuptohet me shtetin e selisë së vendit të arbitrazhit, ndërsa me *“ligjin sipas të cilit është dhënë vendimi”* nënkuptohet me ligj procedural që kanë qeverisur procedurën e arbitrazhit”.

Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës konstaton se duke pasë për bazë Konventën e ashtuquajtur Nju Jork-ut e vitit 1958 e cila është e zbatueshme sipas nenit 26 të Ligjit 04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK) me ç’rast njohja dhe përmbarimi i Tribunalit të huaja bëhet në përputhje me konventën e Nju Jork-ut dhe të drejtën ndërkombëtare tregtare të Kombëve të Bashkuar (UNCITRAL) për zbatimin e Konventës së Nju Jork-ut, dhe të nenit 39 të ligjit të Arbitrazhit të Republikës së Kosovës, pretendimet e paditësit për anulimin e vendimit të arbitrazhit të huaj paraqiten në rastin e procedurës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj, kështu në rastin konkret pretendimet e paditësit paraqiten gjatë procedurës së lartë cekur dhe nuk ka mundësi ligjore që në ndonjë procedurë tjetër të rregullt të kërkohet anulimi i një vendimi të tillë. Andaj, për këto arsye sipas Dhomës së Shkallës së Dytë drejtë ka vendos gjykata e dhomës së shkallës së parë kur është shpallë si jokomptente lidhur me një kërkesëpadi të tillë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 209 par.1.nën par. b), e lidhur me nenin 208 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë,

K.Dh.Sh.nr.954/2024, dt.24.05.2024

Kryetare e Kolegjit

Franciska Zhitija - Ymeri

Numri i lëndës: 2022:097187
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05741795